

AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË "Burcher Business Solutions" Sh.p.k.

Sot, me datë 12/05/2024,

Z. Michael Willim Burcher, shtetas suedez, i biri i John Burcher, lindur më 21 gusht 1969, banues në Tiranë, e mbajtës i Kartës së Identitetit me nr. 64, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar;

Në përputhje me ligjin 9901, datë 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" (i ndryshuar) dhe ligjit nr. 9723, dt. 03.05.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit", kam vendosur të themeloj një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar të emërtuar "**Burcher Business Solutions**" Sh.p.k. (më poshtë referuar si "Shoqëria").

NENI 1
EMËRTIMI

Emri i Shoqërisë është "Burcher Business Solutions" Sh.p.k.

NENI 2
SELIA

Selia zyrtare e Shoqërisë ndodhet në adresën: Rruga e Kavajës, Kompleksi Square 21 Arlis, Shkalla 4, Kati 6, Ap.4.6.20/1, Tirane.

Asambleja e ortakëve mund të themelojë filiale, seli dytësore ose njësi të tjera operative si dhe të transferojë selinë e shoqërisë në një adresë apo qytet tjetër.

NENI 3
KOHËZGJATJA

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë për një afat të pacaktuar, përveç zgjatjes ose prishjes së mëparshme të saj sipas vendimit të Asmablesë së Ortakëve.

NENI 4
OBJEKTI

Qëllimi i shoqërisë është të kryejë çdo veprimtari të lejuar nga ligji dhe/ose të marrë pjesë në çdo veprim apo veprimtari juridike që mund të kryhet nga një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e krijuar në bazë të legjislacionit shqiptar.

Më konkretisht, por pa u kufizuar në to, objekti i shoqërisë është:

Menaxhim projektesh, shërbime trajnimi dhe shërbime marketingu.



NENI 5

KAPITALI THEMELTAR

Kapitali themeltar është i përbërë nga kontributet në të holla të ortakëve themelues në vlerën 100 Lekë (nje qind) dhe është i ndarë në 1 kuote me vlere nominale 100 Leke e cila zoterohet nga ortaku i vetem i Shoqërise.

Kapitali themeltar mund të zmadhohet nëpërmjet kontributeve të reja në para ose në natyrë, sipas vendimeve të asamblesë së ortakëve të marra më shumicat të parashikuara për ndryshimin e këtij statuti.

NENI 6

ORGANET E SHOQËRISË

Organet e shoqërisë përbëhen nga Asambleja e ortakëve dhe Organi administrativ.

- Asambleja e ortakëve është organi vendimmarrës i shoqërisë e cila vepron në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.
- Organi i vetëm administrativ i shoqërisë është Administratori i vetëm, **Z. Michael Willim Burcher**, shtetas suedez, i biri i John Burcher, lindur më 21 gusht 1969, banues në Tiranë, e mbajtës i Kartës së Identitetit me nr. 64, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar, i cili zgjidhet për një periudhë prej 5 (pesë) vjet, me të drejtë rizgjedhjeje, nga data 03.05.2024 deri ne 02.05.2029.

NENI 7

LEGJISLACIONI I APLIKUESHËM

Aktiviteti i shoqërisë do të rregullohet nga dispozitat e statutit të shoqërisë, si dhe nga të gjitha dispozitat ligjore në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

NENI 8

DISPOZITA FINALE

Ky Akt Themelimi hartohet në 3 (tre) kopje origjinale në gjuhën shqipe.
Permbajtja e Aktit të Themelimit u lexua dhe nënshkrua nga Ortakët themelues të shoqërisë duke autorizuar **Administratorin Z. Michael Willim Burcher** për të kryer të gjitha veprimet e nevojshme për regjistrimin e shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit (QKB) në Tiranë.

ORTAKU THEMELUES

Michael Willim Burcher

Michael William Burcher

